



**DRAFT**

**MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV**

**NË MES TË**

**ZYRËS EVROPIANE KUNDËR MASHTRIMIT**

**DHE**

**POLICISË SË KOSOVËS**

Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF),

dhe

Policia e Kosovës,

(tutje referuar si “Partnerët”, secili si “Partner”)

- Duke marrë parasysh Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë, dhe Kosovës\*, në anën tjetër;
- Duke marrë parasysh Kornizën e Marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Komisionit Evropian mbi Marrëveshjet për Zbatimin e Asistencës Financiare të Bashimit për Kosovën nën Instrumentin për Asistencë për Para-Pranimi (IPA II), dhe në veçanti Neni 50 dhe 51 prej sajë;
- Duke pasur parasysh Rregulloren (EU, Euroatom) No 883/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nga 11 Shtatori 2013 lidhur me hetimet e bëra nga zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF)<sup>1</sup>, dhe në veçanti Nenit 14(1) prej sajë;
- Në funksion të misionit të OLAF lidhur me luftimin e mashtrimit, korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera joligjore që ndikojnë interesat financiare të Bashkimit Evropian nën Nenin 325 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian, si dhe në lidhje me shkeljet e rënda të anëtarëve apo stafit të institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit Evropian;
- Në funksion të misionit të Policisë së Kosovës në ofrimin e sigurisë dhe shërbimeve për të gjithë personat në Kosovë bazuar në ligj, praktikën dhe standardet më të mira të policimit demokratik;

Synojnë të bashkëpunojnë siç përcaktohet në pjesën në vazhdim.

## **1. Qëllimi i marrëveshjes**

---

\* This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence.

<sup>1</sup> OJ L 248, 18.9.2013, p.1.

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit Administrativ (tutje “Marrëveshja”) synon, brenda kornizave të caktuara ligjore që rregullojnë këto aktivitete<sup>2</sup>, rritjen e transmetimit të informacioneve me kohë dhe bashkëpunimin në rastet që kanë të bëjnë me mashtrimet e pretenduara, korrupsion apo aktivitete të tjera ilegale që ndikojnë interesat financiare të Bashkimit Evropian, si dhe shkeljen e rëndë të anëtarëve apo stafit të institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit Evropian.

## **2. Natyra e marrëveshjes**

- 2.1. Kjo Marrëveshje përcakton kornizën për marrëdhëniet e punës në mes të Partnerëve, subjekt ndaj disponueshmërisë së resurseve.
- 2.2. Kjo Marrëveshje nuk ka synim që të krijoj ndonjë obligim nën ligjin ndërkombëtarë apo të Bashkimit Evropian, për të modifikuar ndonjë rregull ekzistues ligjor, përfshirë imunitetet dhe privilegjet e BE-së dhe stafit të sajë, apo të interferojë me kornizat ligjore që qeverisin Partnerët. Kjo Marrëveshje nuk mbulon asistencën e ndërsjellë ligjore.

## **3. Ofrimi i informatave**

- 3.1. Kur Policia e Kosovës informon OLAF për ekzistimin e pretendimeve të besueshme për rastet referuar në pjesën 1, Partnerët do të hulumtojnë mënyra për të bashkëpunuar dhe për të siguruar përcjelljen e duhur.
- 3.2. Kur bashkëpunohet në ndonjë rast specifik, Partnerët do të ofrojnë njëri tjetrit informata relevante, përfshirë të dhënat personale, në mënyrë që të arrijnë qëllimin e kësaj Marrëveshje. Ky shkëmbim informatash do të përmbajë elemente të mjaftueshme për të identifikuar:
  - Personat, operatorët apo subjektet ekonomike që dyshohet se janë përfshirë;
  - Natyrën e mashtrimit, korrupsionit apo aktiviteteve të tjera ilegale; apo natyrën e shkeljes së rëndë; dhe
  - Ndonjë rrethanë tjetër relevante.
- 3.3. Shkëmbim të informatave të cilat eventualisht do të qojnë në identifikimin e personave të mbuluar me privilegje dhe imunitete të BE-së bëhet pa ndonjë paragjykim ndaj këtyre privilegjeve dhe imuniteteve.
- 3.4. Me kërkesë të arsyetuar mirë nga OLAF, Policia e Kosovës do të informojë OLAF, në mundësinë e parë, nëse është në dijeni për ndonjë hetim penal në proces apo procedime gjyqësore që mund të jetë relevante me hetimet e OLAF.

## **4. Bashkëpunimi në rastet specifike**

---

<sup>2</sup> For OLAF, in particular: Regulation (EU, Euratom) No 883/2013 and Commission Decision 1999/352/EC, ECSC, Euratom of 28 April 1999 establishing the European Anti-fraud Office (OLAF) (OJ L 136, 31.05.1999, p. 20); for the Kosovo Police: [Kosovo Penal and Procedural Cod, Law on Police, Law on Money Laundering and Financing Terrorism, Law on protection of Personal Data ]

- 4.1. Kurdo që është e përshtatshme, Policia e Kosovës do të mbështesë OLAF në hetimet e saja, në veçanti duke asistuar OLAF në përgatitjen dhe kryerjen e kontrolleve dhe inspektimeve në vend-ngjarje apo aktiviteteve të tjera hetuese në territorin e Kosovës. Kur është e aplikueshme, Policia e Kosovës do të mbështesë OLAF në identifikimin e autoriteteve të cilat janë kompetente për të asistuar OLAF në kryerjen e kontrollimeve dhe inspektimeve në vend-ngjarje në Kosovë.
- 4.2. Kurdo që është e përshtatshme, Partnerët subjekt të ligjeve të zbatueshme, mund të kryejnë kontrollime të përbashkëta në vend-ngjarje. Në raste të tilla, OLAF dhe Policia e Kosovës do të veprojnë në kuadër të kornizës së caktuar ligjorë të aplikueshme<sup>3</sup>.

## **5. Asistenca teknike**

Komfort rregullave relevante dhe varësisht disponueshmërisë së resurseve, Partnerët mund të ofrojnë njëra tjetrës asistencë teknike, përfshirë shkëmbimin e praktikave më të mira dhe shkëmbimin e ndonjë informacioni të nevojshëm teknik.

## **6. Analizat strategjike**

- 6.1. Partnerët mund të shkëmbejnë informata relevante strategjike qoftë në mënyrë spontane apo me kërkesë. Shembuj të informatave strategjike mund të përfshijnë:
  - Dobësitë e mundshme në menaxhimin e fondeve të BE-së në Kosovë;
  - Strukturat Operacionale të organizatave të përfshira në aktivitete mashtruese , si dhe lidhjet në mes këtyre organizatave që operojnë brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian dhe Kosovë; dhe
  - Strategjitë, modi operandi, teknikat dhe financimi i këtyre organizatave.
- 6.2. Partnerët mund të bashkëpunojnë në fushën e vlerësimit të kërcënimit dhe analizimit të riskut. Për këtë qëllim, dhe në pajtueshmëri me rregullave relevante, Partnerët mund të ndajnë mjetet e tyre specifike teknike dhe materialet.

## **7. Konfidencialiteti, përdorimi i informatave nga Partnerët dhe në relacion me palët e treta**

- 7.1. Informatat e komunikuar apo të pranuar nën këtë Marrëveshje mbrohen nga fshehtësia profesionale siç përcaktohet në rregullat ligjore të aplikueshme në Policinë e Kosovës dhe sa i përket OLAF në kushte të Nenit të 10 të Rregullores së BE-së (EU, Euroatom) 883/2013.
- 7.2. Shkëmbimi i informatave nën këtë Marrëveshje është pa paragjykim ndaj kufizimeve lidhur me konfidencialitetin të hetimeve penale apo procedurave nacionale gjyqësore si dhe ndaj ndalesave të shqiptuara nga palët e treta mbi informatat e ofruara nga ta.
- 7.3. Partnerët do të përdorin informatat e transmetuara në përputhje me këtë Marrëveshje vetëm për qëllime referuar në Pjesën 1. Ata mund të zbulojnë informata të tilla tek palët e treta për qëllime tjera vetëm në marrëveshje me Partnerin i cili ka ofruar informacionin.

---

<sup>3</sup> For OLAF, the applicable requirements are laid down in Article 3 of Regulation 883/2013.

## **8. Mbrojtja e të dhënave**

- 8.1. Të gjitha transferet e të dhënave personale të mbajtura nga OLAF në Policinë e Kosovës dhe përpunimi i të dhënave personale të pranuar nga Policia e Kosovës, janë subjekt i kërkesave të Rregullorës (EC) 45/2001, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e individëve.<sup>4</sup>
- 8.2. Të gjitha transferet e të dhënave personale të mbajtura nga Policia e Kosovës në OLAF, si dhe përpunimi i të dhënave personale të pranuar prej OLAF nga Policia e Kosovës, bëhen në pajtueshmëri me ligjet në fuçi, dhe konform parimeve të përcaktuara në klauzolat për mbrojtjen e të dhënave të shtuara në këtë Marrëveshje.

## **9. Personat kontaktues dhe modalitetet për transmetimin e informatave**

- 9.1. Secili partner do t'i caktoj personat kontaktues brenda organizatës së tyre, për implementimin e kësaj Marrëveshje, duke përfshirë shkëmbimin e informatave dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me aktivitetet e bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshje.
- 9.2. Personat e caktuar kontaktues janë specifikuar në Aneksin 2. çdo ndërrim i personave të caktuar kontaktues do të njoftohet menjëherë, në formë të shkruar.
- 9.3. Në rast të ndonjë kërkesë për informacion, partnerit të cilit i'u është parashtruar kërkesa, do të jap një përgjigje fillestare sa më shpejtë të jetë e mundur dhe jo më vonë se 15 ditë nga pranimi i kërkesës.

## **10. Vlerësimi i bashkëpunimit**

Partnerët mund ta vlerësojnë aplikimin e kësaj Marrëveshje sipas nevojës.

## **11. Të ndryshme**

Marrëveshja aktuale aplikohet nga data e nënshkrimit të saj nga secili Partner. Ajo mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë përmes shkëmbimit të shkresave apo të ndërpritet nga secili Partner duke njoftuar paraprakisht me shkrim dy muaj më herët.

\*\*\*

Nënshkruar në \_\_\_\_\_ me datë \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Drejtor-Gjeneral  
Zyra Europiane Kundër  
Mashtrimit (OLAF)

<sup>4</sup> Rregullorja (EC) Nr 45/2001 e Parlamentit Europian dhe e Kwshillit, OJ L 8, 12.1.2001, p. 1.

## ANEKSI 1

### KLAUZOLAT E MBROJTJES SË TË DHËNAVE LIDHUR ME MARRËVESHJEN PËR BASHKËPUNIM ADMINISTRATIV NDËRMJET OLAF-IT DHE POLICISË SË KOSOVËS

OLAF dhe Policia e Kosovës, duke vepruar në mirëbesim, garantojnë dhe marrin përsipër se do t'i ndjekin marrëveshjet praktike të specifikuara në klauzolat në vijim, dhe se kanë të drejtë ligjore për të vepruar ashtu.

#### 1. DEFINICIONET

1.1. “të dhënat personale”, ”kategoritë e veçanta të të dhënave”, ”përpunimi i të dhënave personale”, ”kontrolleri”, ”procesori”, ”subjekti i të dhënave”, dhe “Mbrojtja adekuate” kanë domethënie të njëjtë sikurse në Rregullorën (EC) 45/2001<sup>5</sup>.

1.2. “Të dhënat personale të OLAF” do të thotë të dhënat personale që janë transefruar nga OLAF tek Policia e Kosovës në kontekstin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi administrativ.

1.3. “Të dhënat personale të Policisë së Kosovës” do të thotë të dhënat personale që janë transferuar nga Policia e Kosovës tek OLAF në kontekstin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi administrativ.

1.4. “Partneri importues” do të thotë Partneri i marrëveshjes së bashkëpunimit administrativ i cili importon të dhënat personale nga Partneri tjetër.

1.5. “Partneri eksportues” do të thotë Partneri i marrëveshjes së bashkëpunimit administrativ, të i cili i eksporton të dhënat personale tek Partneri tjetër.

#### 2. ZOTIMET E PËRBASHKËTA

2.1. Partneri importues mund t'i përpunojë të dhënat personale të Partnerit eksportues vetëm për qëllime siç përshkruhen në Sektorin 1 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Administrativ.

2.2. Partneri importues i ka në dispozicion masat e duhura teknike dhe organizative për t'i mbrojtur të dhënat personale të partnerit eksportues ndaj shkatërrimit aksidental dhe të paligjshëm apo humbjes aksidentale, ndryshimit të tyre, zbulimit apo qasjes së paautorizuar, dhe ofron një nivel të duhur sigurie ndaj rreziqeve të paraqitura nga procesimi dhe natyra e të dhënave që duhet mbrojtur. Partneri importues do t'i procesojë të gjitha të dhënat e pranuar nga Partneri eksportues në ambientet e veta, dhe nuk do t'i procesojë të dhënat me anë të shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të jashtme.

2.3. Partneri importues ka në dispozicion procedurat për të siguruar se çdo palë e tretë të cilën ai e ka autorizuar që të ketë qasje në të dhënat personale të Partnerit eksportues, duke përfshirë edhe procesorët, do ta respektojë dhe mirëmbajë konfidencialitetin dhe sigurinë e atyre të dhënave. Çdo person që vepron nën autoritetin e partnerit importues, duke përfshirë edhe përpunuesin e të dhënave, do t'i kërkohet që t'i përpunojë të dhënat personale vetëm me udhëzimet nga partneri importues dhe vetëm në ambientet e partnerit importues.

<sup>5</sup> Rregullorja (EC) No 45/2001 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, OJ L 8, 12.1.2001, p. 1.

2.4. Partneri importues mund t'ia zbuloj të dhënat personale të ofruara nga Partneri eksportues, autoriteteve qeveritare, përfshirë edhe autoritetet jo-qeveritare të BE-së, vetëm me marrëveshje të shprehur të Partnerit eksportues. Marrëveshja e tillë duhet të bëhet nga partneri eksportues në çdo rast të zbulimit të propozuar, por para se të bëhet zbulimi.

(i) Kushtet e shprehura të zbulimit do ta obligojnë autoritetin e tillë qeveritar të:

- (1) përdorë të dhënat personale vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave financiare,
- (2) siguroj shkatërrimin e duhur të ndonjë të dhëne personale të pranuar, në përputhje me procedurat e mbajtjes së të dhënave të autoritetit, dhe
- (3) Siguroj lejën e shprehur të partnerit eksportues për përhapje të mëtutjeshme.

(ii) Dështimi në respektimin e kushteve për transferim, mund të hetohet dhe t'i raportohet Partnerit eksportues dhe autoriteti i tillë qeveritar të kategorizohet si i papërshtatshëm në pranimin e transfereve vijuese nga partneri importues i të dhënave personale të partnerit eksportues.

2.5. Sipas kërkesës, secili nga partnerët do t'i siguroj partnerit tjetër ndonjë agjent apo auditor të pavarur/paanshëm për inspektim, të cilin e zgjedh partneri inspektues dhe i cili nuk është kundërshtuar në menyrë të arsyeshme nga Partneri inspektues, apo gjykata kompetente, sipas rastit, me dëshmi të mjaftueshme të përputhshmërisë, dhe do të demonstroj efektivitetin e masave të ndërmarra.

### **3. ZOTIMET E OLAF**

3.1. Të dhënat personale të Policisë së Kosovës do të përpunohen dhe transferohen tutje nga OLAF në pajtueshmëri me ligjet aplikueshme të OLAF, ne veçanti me nenet 7 dhe 8 të Kartës së të Drejtave Themelore të Njeriut dhe Rregullores së EU-së (EC) No. 45/2001.

3.2. Të dhënat personale të OLAF mblidhen, përpunohen dhe transferohen në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme të OLAF, dhe në veçanti në pajtueshmëri me nenet 9 të Rregullorës 45/2001.

3.3. OLAF ka bërë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar që Policia e Kosovës është në gjendje t'i përmbushë zotimet e saj sipas këtyre dispozitave.

3.4. OLAF i ka ofruar Policisë së Kosovës një kopje të Rregullorës (EC) 45/2001 dhe poashtu (kurdo që kërkohet) do t'i ofroj kopje të ndonjë ligji tjetër përkatës për mbrojtjen e të dhënave apo referenca të BE-së, dhe do ta mbajë të informuar rreth ndonjë ndryshimi me ligjet relevante të zotimeve të OLAF-it në lidhje me këtë Marrëveshje bashkëpunimi Administrativ.

3.5 OLAF do t'i implementoj masat e duhura dhe efektive për të siguruar që parimet dhe obligimet e përcaktuara në Rregullorën 45/2001 janë të kënaqshme, dhe do ta demonstroj pajtueshmërinë me EDPS sipas kërkesës së saj.

3.6. OLAF do t'i përgjigjet kërkesave nga subjektet e të dhënave dhe të Mbikëqyrësit European për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPS) në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të OLAF nga Policia e Kosovës, përveq nëse Partnerët jenë pajtuar në ndonjë rast të veçantë

që përgjigjen ta jap Policia e Kosovës. Në këtë rast, OLAF do t'i përgjigjet për aq sa të jetë e mundur dhe aq sa ka informata të arsyeshme në dispozicion, nëse Policia e Kosovës nuk është e gatshme apo nuk ka mundësi të përgjigjet. Përgjigjet duhet të jipen brenda tre muajve.

3.7. OLAF do të vë në dispozicion të subjekteve të të dhënave, sipas kërkesës, një kopje të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi Administrativ dhe Aneksin e saj.

3.8. OLAF do të regjistrojë çdo transferim apo seri transferimesh të të dhënave personale të OLAF, dhe secilin transferim të të dhënave personale të Policisë së Kosovës tek pala e tretë. Gjithashtu do të regjistrohet secila kërkesë nga Policia e Kosovës për transferim të të dhënave personale të OLAF, dhe përgjigjen e OLAF. Në regjistra do të specifikohen subjektet e të dhënave dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave, qëllimi i transferit, kategoritë e të dhënave të transferuara, pranuesi, nëse kategoritë e veçanta të të dhënave janë me interes, dhe ndonjë informacion tjetër relevant dhe të nevojshëm.

#### **4. ZOTIMET NGA POLICIA E KOSOVËS**

4.1. Për t'i mundësuar OLAF-it t'i përmbush obligimet e veta për të sjellë mbrojtje adekuate për të dhënat personale që i shkojnë një pranuesi që nuk i nënshtrohet regjimit të mbrojtjes së të dhënave të BE-së, Policia e Kosovës garanton dhe merr përsipër të procedojë të dhënat personale të OLAF në përputhje me Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave të përcaktuara në Shtojcën e këtyre dispozitave.

4.2. Policia e Kosovës garanton dhe merr përsipër se nuk ka arsye të besohet, në momentin e hyrjes në këto dispozita, në ekzistimin e ndonjë ligji të cilit i nënshtrohet dhe që do të kishte ndikim substancial negativ në garancionet e parapara në këto dispozita, dhe do ta informojë OLAF në qoftë se është në dijeni për ligje të tilla.

#### **5. INTERPRETIMI I KLAUZOLAVE**

Ky aneks do të interpretohet në përputhje me obligimet e OLAF sipas ligjeve të aplikueshme të BE-së, siç interpretohet nga gjykatat e BE-së.

#### **6. ZGJIDHJA E KONTESTEVE ME SUBJEKTET E TË DHËNAVE APO EDPS**

6.1. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje apo pretendimi të dalë nga një subjekt i të dhënave apo Mbikëqyrës Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPS) në lidhje me përpunimin e të dhënave personale ndaj njëres apo të dyja palëve Partnere, Partnerët do ta informojnë njëri-tjetrin, dhe do të bashkëpunojnë me qëllim të arritjes së zgjidhjes në mënyrë miqësore me kohë.

6.2. Partnerët bien dakord t'i përgjigjen çdo procedure jo-detyruese ndërmjetësimi në dispozicion të iniciuar nga një subjekt të dhënash apo nga EDPS. Nëse marrin pjesë në procedura, Partnerët mund të zgjedhin të marrin pjesë nga distanca (siç është me anë të telefonit apo mjeteve tjera elektronike). Partnerët gjithashtu pajtohen të marrin në konsideratë pjesëmarrjen në ndonjë arbitrazh, ndërmjetësim jo-detyrues apo procedure tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që bërë për mosmarrëveshjet e mbrojtjes së të dhënave

6.3. Në rast se të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve siç përcaktohen në pikat 6.1 dhe 6.2 dështojnë, OLAF duhet të bartë përgjegjësinë në përputhje me Nenin 32 të

Rregullores (EC) 45/2001 për çdo dëm të shkaktuar ndaj subjektit të të dhënave si rezultat i shkeljes së këtyre dispozitave. Përgjegjësia e tillë mbulon dëmet që rezultojnë nga shkeljet e kryera nga Policia e Kosovës në rastet kur subjekti i të dhënave nuk ka qenë në gjendje që në mënyrë të arsyeshme të marrë dëmshpërblimin nga Policia e Kosovës.

## **7. PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI**

7.1. Në rast se secili Partner dështon të respektojë detyrat e tij sipas këtyre dispozitave, Partneri tjetër mund të pezullojë përkohësisht transferimin e të dhënave personale derisa shkelja të korrigjohet apo Marrëveshja për Bashkëpunim Administrativ të përfundoj.

7.2. Në rast se transferimi i të dhënave personale pezullohet nga ndonjëri prej Partnerëve, apo Marrëveshja për Bashkëpunim Administrativ përfundon në përputhje me Pikën 6, EDPS do të informohet për këtë. Pezullimi apo përfundimi i tillë nuk përjashton Partnerët nga zotimet dhe/apo kushtet sipas këtyre dispozitave sa i përket përpunimit e të dhënave personale tanimë të transferuara.



**SHTOJCË**  
**PARIMET E MBROJTJES SË TË DHËNAVE**

1. Kufizimi i Qëllimit: Të dhënat personale mund të përpunohen dhe rrjedhimisht të përdoren apo të komunikohen tutje vetëm për qëllime të përkrahura në Seksionin 1 të Marrëveshjes për Bashkëpunim Administrativ apo rrjedhimisht të autorizohen nga subjekti i të dhënave.
2. Cilësia e të dhënave dhe proporcionaliteti: Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të mbahen të përditësuara. Të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe jo të tepërta në lidhje me qëllimet për të cilat transferohen dhe procedohet tutje. Të dhënat duhet të mbahen në atë formë që lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave por jo më gjatë së që është e nevojshme për qëllime për të cilat të dhënat janë mbledhur apo janë proceduar tutje.
3. Transparenca: Kontrolluesi duhet ti ofrojë subjekteve të dhëna me informacione të specifikuar në përputhje me Nenet 11 dhe 12 të Rregullores 45/2001. Ofrimi i informatave të tilla mund të shtyhet në përputhje me Nenin 20.
4. Siguria dhe konfidencialiteti: Duhet të merren masa teknike dhe organizative të sigurisë nga kontrolluesi i të dhënave, masa të cilat janë në përputhje me rreziqet, siç janë ato kundër shkatërrimit aksidental apo të paligjshëm ose humbjes aksidentale, ndryshimeve, zbulimit apo qasjes së paautorizuar, që dalin nga përpunimi. Çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit të të dhënave, duke përfshirë përpunuesin, nuk duhet të përpunojë të dhëna përveç me udhëzime nga kontrolluesi i të dhënave.
5. Të drejtat për qasje, korrigjim, fshirje apo kundërshtim: Subjektet e të dhënave duhet të kenë qasje në të dhënat e tyre personale dhe duhet të jenë në gjendje të kenë të dhënat e tyre të korrigjuara, bllokuara apo fshira në përputhje me Nenet 13-16 të Rregullores. Njoftimet për ndonjë korrigjim, bllokim apo fshirje për palët e treta për të cilat të dhënat janë zbuluar, nuk duhet të bëhen kur përfshihen përpjekje joproporcionale. Subjekt i të dhënave gjithashtu duhet të jetë në gjendje të kundërshtojë përpunimin e të dhënave personale që lidhen me të, nëse ka baza të forta ligjore në lidhje me situatën e veçantë. Barra e provës për ndonjë refuzim bie mbi importuesin e të dhënave, dhe subjekti i të dhënave gjithmonë mund të sfidojë refuzimin para EDPS.
6. Kategoritë e veçanta të të dhënave: kontrolluesi do të ndërmarrë masa të tilla shtesë (shembull. Në lidhje me sigurinë) nëse janë të nevojshme për mbrojtjen e kategorive të tilla të veçanta të të dhënave siç përcaktohet me Rregulloren (EC) 45/2001.

## ANEKSI 2

### Personat Kontaktues

Në pajtueshmëri me Seksionin 9. Të Marrëveshjes, Partnerët caktojnë personat kontaktues në vijim:

#### Në Zyrën Evropiane Kundër Mashtrim (OLAF):

- Për kontakte fillestare, Udhëheqësi i Njesisë 0.1 "Investigation Selection and Review" (detajet e kontaktit: Z. Lothar Kuhl, Email: [OLAF-FMB-SPE@ec.europa.eu](mailto:OLAF-FMB-SPE@ec.europa.eu); tel: +32 2 2963925)
- Për përcjelljet që lidhen me rastin, OLAF do të ofrojë Policisë së Kosovës detaje të personit kontaktues relevant

#### Në Policinë e Kosovës:

- Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatim të Ligjit (email: [ilecu@kosovopolice.com](mailto:ilecu@kosovopolice.com); Tel. +3813850801047)